



## KOMUNIKATË

**07. 12. 2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, miratoi sot raportet nga mbledhjet 43, 44 dhe 70/ 2009 dhe u informua me një varg aktiviteteve që po zhvillohen lidhur me procesin zgjedhor. Fillimisht, kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta kërkoi nga kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani që ta informoj KQZ-në për aktivitetet javore. Kryeshefi z. Xhemajl Peqani, tha se janë mbajtur trajnimet e trajnerëve të KVV-ve në Vushtrri, lidhur me procedurat e votimit, të numërimit dhe të paketimit. Gjithashtu, në Vushtrri është mbajtur trajnimi me ZE të KKZ-ve për trajnimin e procedurave të pranimit të materialit zgjedhor nga QV-të të INTEK. Gjithashtu, janë mbajtur takime me Policinë e Kosovës, KFOR-in, Policinë e ELEX-it, OSBE-në dhe IFES-in lidhur me koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me planin e sigurisë gjatë tërë procesit zgjedhor për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për kryetar të Komunave.

Kryeshefi Xhemajl Peqani, e ka informuar KQZ –në se ka përfunduar prodhimi i 1.085.100 fletëvotimeve për Raundin e Dytë Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. Nga data 29.11.2009, subjektet politike kanë sjellë propozimet për KVV-të lidhur me ndryshimet e ZE-e të KKZ-ve. ZE sot deri në përfundim të orarit të punës, janë të obliguara t'i dorëzojnë propozimet në SKQZ. Kurse SKQZ prej datës 06.12.2009, do t'i prezantojë për nominim në KQZ.

Gjithashtu, janë duke u bërë pagesat sipas kontratave të kryera nga operatorët ekonomik. Ka përfunduar prodhimi i LVP-e nga kompania “Dukagjini” dhe, tani ajo gjendet në depon e KQZ-se. Për raundin e dytë të zgjedhjeve, ka filluar ristrukturimi i stafit për QNR-të, dhe ky staf është duke i vijuar trajnimet shpesh për punët dhe detyrat që do të kryhen në QNQ. Në pikat shpërndarëse për raundin e dytë të zgjedhjeve, janë dërguar fletëvotimet, udhëzimet për mënyrën e shkarkimit të fletëvotimeve për votuesit jashtë Kosovës gjegjësisht për OVPP-në.

Gjithashtu, kemi dërguar fletëvotimet edhe pikave distribuive në Malin e Zi (Beran dhe Sutomore), kurse për Serbi në Komitetin e Helsinkit. Janë bërë të gjitha përgatitjet për Votimin e Votuesve me Nevoja të Veçanta, duke filluar nga caktimi i ekipeve mobile për 21 komuna me 75 ekipe mobile për tri kategoritë. Është duke vazhduar procesi i rregullt i Fazës së Dytë të Auditimit të rregullt nga ana Zyres së Auditorit gjeneral të Kosovës.

Janë dorëzuar në Thesar të gjitha listat për pagesat e KVV-ve, stafit tjetër teknik të angazhuar në Ditën e Zgjedhjeve për Raundin e Parë të Zgjedhjeve me 15 nëntor 2009, dhe ky staf që nga data 07.12.2009 ka mundësi të marr pagat e tyre në të gjitha komunat për punën e kryer. Në depo janë duke u përgatitur pakot me material zgjedhor për

material josensitiv, të cilat do të dërgohen në terren javën e ardhshme. Më 04 dhe 05 dhjetor janë dërguar kutitë e votimit dhe kabinat e votimit në komuna ku kanë pasur nevojë për to.

Në mbledhjen e sotshme të KQZ-së, Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së, i ka paraqitur KQZ-së rekomandimet për akreditim të vëzhguesëve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve që do të mbahen më 13 dhjetor për Kryetar të Komunave. ZRPP, deri më 5 dhjetor 2009, ka procesuar aplikacionet e vëzhguesve shtesë për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve të dy (2) subjekteve politike ( LDK: 346 vëzhgues, PDK: 190 vëzhgues ), të një (1) organizate ndërkombëtare ( European Commission Liaison Office me 2 vëzhgues) dhe të një ambasade ( Ambasada e Zvicres me 2 vëzhgues). Raporti përmban rekomandimin për akreditim të gjithsej, 540 vëzhguesëve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka miratuar rekomandimet për akreditimin e këtyre vëzhguesëve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është njoftuar edhe me Listën e Ankesave për KZAP-in dhe KQZ-në të bëra nga subjektet dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe nga personat kandidatë për Asambletë Komunale. KQZ është informuar se janë bërë 23 ankesa të ndryshme. Anëtarët e KQZ-së ë shqyrtim të kësaj informate, kanë vërejtur që një pjesë e ankesave janë në kompetencë të KZAP-it dhe KQZ nuk mund të marrë vendim për to. Burim Ahmeti, koordinatori i QNR-së, ka informuar se në QNR janë shqyrtuar 8 ankesa me kërkesën e KQZP-it. Pas analizës shqyrtuese, KQZ ka vendosur që të kompletohet gjithë dokumentacioni lidhur me ankesat, në mënyrë që të kihet një pasqyrë detale dhe të vendoset për to në bazë të ligjit.